

*A mendoni për kthimin tuaj në Shqipëri?
Po kërkoni informacione për asistencën që mund t'ju ofrohet për kthimin tuaj në Shqipëri?*

Për më shumë informacion mbi procedurat e aplikimit për programin e kthimit të asistuar në Shqipëri të Këshillit Belg të Refugjatëve:

- ✓ Kontakto the Zyrën e Ndhmës për Rikthimin të Vluchtelingenwerk Vlaanderen:
Me telefon: 02/ 274 00 23
Me e-mail: terugkeer@vluchtelingenwerk.be

ose

- ✓ Kontakto organizatën REAB që keni më pranë. Ata mund t'ju japin informacion se si të nisni aplikimin dhe do ta përcjellë dosjen tuaj te Këshilli Belg i Refugjatëve.

Për të gjetur adresën e organizatës "REAB" më të afërt, kontaktoni the Zyrën e Ndhmës për Rikthimin të Vluchtelingenwerk Vlaanderen.



Photos : EC/Europaid - Publisher: Pieter De Gryse, Gaucheretstraat 164, 1030 Brussels, Belgium

Vluchtelingenwerk Vlaanderen ndihmon njerëzit që kthehen në Shqipëri, duke ofruar mbështetje për një riintegrim të qendrueshëm. Ju mund të përfitoni nga kjo ndihmë që i shtohet mbështetjes që mund të merrni nga programi REAB i Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin.

Për të ofruar këtë asistencë, Vluchtelingenwerk Vlaanderen punon ngushtësisht me organizata vendase në Shqipëri. Në këtë fletëpalosje ju mund të gjeni informacion mbi partnerët tanë shqiptarë, mbi llojin e ndihmës që ofrohet dhe si të kontaktoni me ne për më shumë informacione për këtë program.

Organizatat tona partnere për përgatitjen, zbatimin dhe ndjekjen e emigrantëve të kthyer të asistuar janë:



Shoqata "Shpresë për të Ardhmen"

Qëllimi kryesor i shoqatës "Shpresë për të Ardhmen" është të ndihmojë në riintegrimin në shoqërinë shqiptare të emigrantëve të kthyer nga vende të ndryshme evropiane, si edhe të asistojë në integrimin profesional dhe social të migrantëve të brendshëm. Shoqata synon të zhvillojë perspektiva të reja arsimore dhe profesionale për të ardhmen e tyre, me qëllim që t'i ndihmojë ata ta gjejnë të ardhmen në Shqipëri, të lehtësojë punësimin, të japë njohuri për hapje biznesi dhe të nxisë integrimin social.

Zyra jonë kryesore është në Tiranë. Shoqata jonë ka gjithashtu zyrë në Shkodër dhe pikë kontakti në Berat. Shoqata jonë mund t'u ofrojë asistencë të kthyerve në Shqipëri kryesisht në qytetet Tiranë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Berat, Fier, Lushnjë dhe rrethinat. Shoqata mund të bashkëpunojë me organizata të tjera për rajone që nuk mbulohen prej nesh si Vlora, Korça, Pogradeci.

GRUPI SHQIPTAR I TE DREJTAVE TE NJERIUT

Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut (FIDH)



Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut, është themeluar në vitin 1996 si një organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse. Qëllimi i krijimit të këtij Grupi, është të punojë intensivisht në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri dhe te shqiptarëve jashtë vendit. Grupi synon te promovojë të drejtat e njeriut në shumë mënyra.

Synimet kryesore të GRUPIT, janë : Njohja dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, Te jetë nje vezhgues (watch dog) i kujdesshëm per te kapur shkeljet e të drejtave të njeriut si dhe një oponent i qeverisë ne rastet e këtyre shkeljeve, Te rritë mbrojtjen në kuadrin e të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë për shtetin e së drejtës dhe të punoj në fushën e të drejtave të minoriteteve dhe grupeve të marginalizuara.

GSHDNJ ofron ekspertizë në keto fusha: Ekspertizë në fushën ligjore, marëdhënie publike dhe shteti I së drejtës, në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, bazuar në monitorime, në advokim.

Organizata jonë ka degët në Korçë, Shkodër (dhe së shpejti në Vlorë, Berat, Gjirokastrë, Kukës, Tropojë). Në Tiranë si dhe në të gjitha rrethet e tjera ku Grupi ka degët e tij. Përveç kësaj, organizata ofron asistencën e vet në të gjithë vendin nëpërmjet bashkëpunimeve që ka me organizata dhe institucione të tjera. GSHDNJ ka bashkëpunime të gjata dhe të dobishme me shumë organizata të tjera në vend, si ato te grave, të të rinjve, mediave, etj.

Në bashkëpunim me organizatat partnere në Shqipëri, Vluchtelingenwerk Vlaanderen mund të ofrojë asistencë si më poshtë:



Përpara largimit:

Para se të vendosni për t'u kthyer dhe për t'u përgatitur për kthimin, ju mund të keni pyetje mbi situatën aktuale në një zonë të veçantë në Shqipëri. Ne mund të sigurojmë informacione për çështje të tilla si: strehimi, arsimimi, punësimi, siguria e personit etj.

Ne gjithashtu ju ndihmojmë të përcaktoni dhe vërtetoni realizueshmërinë e projektit të riintegrimit, me qëllim që të përfitoni nga mbështetja financiare e Fondit të Riintegrimit.

Përveq kësaj ne ju ndihmojmë te aplikoni për mbështetje të veçantë financiare nga fondi Belg i Riintegrimit dhe kjo mund të bëhet deri në një shumë prej maksimum:

- o 700 € për person
- o 1750 € për familje



Pas largimit:

Në marrëveshje me ju, një nga partnerët tanë vendas mund të organizojë pritjen dhe t'ju ndihmojë me të mbërritur në aeroport. Partneri vendas do të financojë projektin e riintegrimit të miratuar dhe mund të sigurojë asistencë për probleme të tjera që mund të keni lidhur me çështje të sigurisë, profesionale, sociale, mjekësore.

Me pëlqimin tuaj partneri vendas do të kërkojë të ruajë kontaktet me ju 12 muaj pas kthimit, me qëllim që të shohë situatën tuaj të riintegrimit dhe t'ju ndihmojë për ndonjë gjë që mund të ketë mbetur.

